

VENDIM
Nr. 584, datë 22.7.2020

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 570, DATË 17.7.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
AGJENCISË KOMBËTARE TË PYJEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 2, të kreut IV, të vendimit nr. 570, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Për nëpunësit e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, të cilët kanë kryer funksione të lidhura me monitorimin dhe kontrollin në fushën e pyjeve, zbatohen dispozitat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama